



FLETORJA ZYRTARE

E

REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

Nr. 38

2002

Korrik

P Ë R M B A J T J A

Faqe

Ligj nr. 8917
datë 4.7.2002

Për disa ndryshime në ligjin nr. 8435, datë 28.12.1998 “Për sistemin e taksave në Republikën e Shqipërisë”, ndryshuar me ligjet nr. 8508, datë 7.7.1999, nr. 8519, datë 30.7.1999, nr. 8552, datë 18.11.1999, nr. 8581, datë 17.2.2000, nr. 8651, datë 28.7.2000, nr.8713, datë 15.12.2000, nr. 8840, datë 11.12.2001 dhe nr. 8858, datë 14.2.2002.....

.....

1147

Ligj nr. 8918
datë 4.7.2002

Për një shtesë në ligjin nr.8087, datë 13.3.1996 “Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura në Republikën e Shqipërisë, të ushtarakëve të Ministrisë së Rendit Publik dhe të Shërbimit Informativ Shtetëror”, ndryshuar me ligjin nr.8521,datë 30.7.1999.....

.....

1148

Ligj nr.8919
datë 4.7.2002

Për disa ndryshime e shtesa në ligjin nr.8003, datë 28.9.1995 “Kodi Penal Ushtarak i Republikës së Shqipërisë”.....

1149

.....

Dekret nr. 3397
datë 3.7.2002

Për lejim lënie të shtetësisë 1156
shqiptare.....

Vendim i Gj.K
nr. 152, datë 5.7.2002

Me objekt shfuqizimin si antikushtetues të vendimit
nr.1205, datë 13.11.2001 të Kolegjit Civil të Gjykatës së
Lartë; vendosja e masës së pezullimit të ekzekutimit të
vendimit nr.238, datë 26.04.2000 të Gjykatës së Rrethit
Gjyqësor Sarandë. 1157
.....

L I G J
Nr. 8917, datë 4.7.2002

PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 8435, DATË 28.12.1998 “PËR SISTEMIN E TAKSAVE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”, NDRYSHUAR ME LIGJET NR. 8508, DATË 7.7.1999, NR. 8519, DATË 30.7.1999, NR. 8552, DATË 18.11.1999, NR. 8581, DATË 17.2.2000, NR. 8651, DATË 28.7.2000, NR.8713, DATË 15.12.2000, NR. 8840, DATË 11.12.2001 DHE NR. 8858, DATË 14.2.2002

Në mbështetje të neneve 78, 81 pika 1, 83 pika 1 dhe 155 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
V E N D O S I:

Në ligjin nr. 8435, datë 28.12. 1998 “Për sistemin e taksave në Republikën e Shqipërisë“, ndryshuar me ligjet nr. 8508, datë 7.7.1999, datë 30.7.1999, nr. 8552, datë 18.11.1999, nr.8581, datë 17.2.2000, nr. 8651, datë 28.7.2000, nr. 8713, datë 15.12.2000, nr. 8840, datë 11.12. 2001, dhe nr. 8858, datë 14.2.2002 bëhen këto ndryshime:

Neni 1

Në lidhjen nr. 2 “Taksa për shërbimet konsullore”, në nënndarjen “I.Taksa për lëshimin e vizave dhe dokumenteve të udhëtimit” bëhen këto ndryshime:

Pika 7 ndryshohet si vijon:

“Taksa e hyrjes në territorin e Republikës së Shqipërisë për shtetasit e huaj, që nuk kanë nevojë për vizë, do të jetë sipas reciprocitetit, por jo më shumë se 10 US\$”.

Në pikën 7/1 shtohet paragrafi me këtë përmbajtje:

“Kjo taksë nuk zbatohet për periudhën 1 maj deri më 1 nëntor”.

Pika 9 ndryshohet si vijon:

“Turistët individë njëditorë dhe ata të organizuar në grupe turistike njëditore nuk paguajnë taksë vize ose taksë hyrjeje”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr. 3407, datë 12.7.2002 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani

L I G J
Nr. 8918, datë 4.7.2002

PËR NJË SHITESË NË LIGJIN NR.8087, DATË 13.3.1996 “PËR SIGURIMIN SHOQËROR SUPLEMENTAR TË USHTARAKËVE TË FORCAVE TË ARMATOSURA NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË, TË USHTARAKËVE TË MINISTRISË SË RENDIT PUBLIK DHE TË SHËRBIMIT INFORMATIV SHTETËROR”, NDRYSHUAR ME LIGJIN NR.8521, DATË 30.7.1999

Në mbështetje të neneve 78, 81 pika 1 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e një grupi deputetësh,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË V E N D O S I:

Në ligjin nr.8087, datë 13.3.1996 “Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura në Republikën e Shqipërisë, të ushtarakëve të Ministrisë së Rendit Publik dhe të Shërbimit Informativ Shtetëror”, ndryshuar me ligjin nr.8521, datë 30.7.1999 bëhet kjo shtesë:

Neni 1

Në nenin 7, “Kushtet për përfitim”, në fund të paragrafit të dytë, pas fjalëve “Në kohën e shërbimit aktiv përfshihet:”, shtohet paragrafi me këtë përmbajtje:

“Koha si punonjës i reparteve të Radiozbulimit të Forcave të Armatosura që, sipas funksionit organik, kanë kryer detyrën e punonjësit të drejtimit dhe të operatorit të radiozbulimit (punonjës posti) si punonjës civil para titullimit ose rititullimit si ushtarak aktiv.”

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 janar 2003.

Shpallur me dekretin nr. 3408, datë 12.7.2002 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani

L I G J Nr.8919, datë 4.7.2002

PËR DISA NDRYSHIME E SHITESA NË LIGJIN NR.8003, DATË 28.9.1995 “KODI PENAL USHTARAK I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”

Në mbështetje të neneve 81 pika 2 shkronja “d” dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË V E N D O S I:

Në ligjin nr.8003, datë 28.9.1995 “Kodi Penal Ushtarak i Republikës së Shqipërisë” bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

Pas nenit 1 shtohen nenet 1/a dhe 1/b me këto përmbajtje:

“Neni 1/a

Bazat e legjislacionit penal ushtarak

Kodi Penal Ushtarak bazohet në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, në parimet e përgjithshme të së drejtës penale ushtarake ndërkombëtare, në marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikura nga shteti shqiptar dhe në ligje të tjera.

Legjislacioni penal ushtarak përbëhet nga dispozitat e këtij Kodi dhe ligje të tjera që

parashikojnë vepra penale ushtarake.

Neni 1/b

Detyrat e legjislacionit penal ushtarak

Legjislacioni penal ushtarak ka për detyrë të mbrojë pavarësinë e shtetit dhe tërësinë e territorit të tij, rendin kushtetues, të drejtat dhe liritë e shtetasve, rendin ushtarak të Forcave të Armatosura, pronën, autoritetin dhe disiplinën ushtarake, nga vepra penale ushtarake dhe parandalimin e tyre, si dhe të sigurojë pjesëmarrjen e shtetasve shqiptarë në mbrojtjen e Republikës së Shqipërisë."

Neni 2

Neni 3 ndryshohet si më poshtë:

"Legjislacioni penal ushtarak zbatohet edhe kur veprat penale ushtarake janë kryer në dëm të një shteti të huaj aleat ose partner me shtetin shqiptar."

Neni 3

Në nenin 6 bëhen ndryshimet si më poshtë:

1. Në paragrafin e parë, pas fjalës "armatosura" hiqen fjalët "gjithashtu, edhe ata persona që ligji i barazon me ushtarakët."

2. Paragrafi i dytë ndryshohet si më poshtë:

"Me fjalën "vartës" kuptohet ushtaraku ose personi me gradë, detyrë ose funksion më të ulët.

Me fjalën "kuadër ose person komandues" kuptohet personi, i cili për arsye të gradës, detyrës ose funksionit, ushtron autoritetin komandues kryesor, sipas shkallëve, nga njësitë më të larta deri në nënrepartin ose njësitë e ulëta."

3. Pika 7 ndryshohet si më poshtë:

"Personat e tjerë që, sipas ligjit të veçantë, janë subjekt i këtij Kodi."

4. Pas pikës 7, shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

"Pavlefshmëria e rekrutimit ose paaftësia për të shërbyer në Forcat e Armatosura nuk e përjashton ushtarakun nga përgjegjësia penale, për vepra penale të parashikuara në këtë Kod."

Neni 4

Në nenin 8, pas pikës 6, shtohen pikat 7 dhe 8 me këto përmbajtje:

"7. Nxjerrja jashtë territorit ose dëbimi i individëve të huaj subjekte të këtij Kodi nga Shqipëria.

8. Detyrimi për publikimin e vendimit gjyqësor."

Neni 5

Pas nenit 8, shtohet neni 8/a me këtë përmbajtje:

"Neni 8/a

Dënimi me burgim të përjetshëm ose me vdekje

Dënimi me burgim të përjetshëm jepet për kryerjen e një krimi të rëndë.

Për kryerjen e një krimi të rëndë në gjendje lufte ose në gjendje të jashtëzakonshme, gjykata mund të japë dënim me vdekje.

Dënimi me burgim të përjetshëm ose me vdekje nuk mund të jepet ndaj personave që, në kohën e kryerjes së krimit, nuk kanë mbushur moshën tetëmbëdhjetë vjeç, si dhe për gratë."

Neni 6

Në nenin 16, në paragrafin e dytë, pas fjalëve "prova gatishmërie" shtohen fjalët "ose

mobilizim”.

Neni 7

Neni 25 ndryshohet si më poshtë:

“Dorëzimi tek armiku, nga kuadri komandues, pa ndonjë domosdoshmëri ushtarake, i forcave ushtarake, mjeteve, armatimit, municionit ose teknikës, që i janë besuar, dënohet me burgim nga pesë vjet deri në njëzet e pesë vjet.

Kur nga kjo vepër janë shkaktuar pasoja të rënda në njerëz ose në teknikë, dënohet me burgim jo më pak se pesëmbëdhjetë vjet.

Po kjo vepër e kryer në gjendje lufte ose në gjendje të jashtëzakonshme, dënohet me burgim jo më pak se njëzet vjet, me burgim të përjetshëm ose me vdekje.”

Neni 8

Në nenin 26 bëhen këto ndryshime:

1. Në paragrafin e parë, fjalët “jo më pak se pesë vjet”, zëvendësohen me fjalët “nga tre deri në dhjetë vjet”.

2. Në paragrafin e dytë fjalët “jo më pak se pesëmbëdhjetë vjet ose me burgim të përjetshëm a vdekje”, zëvendësohen me fjalët “nga dhjetë deri në njëzet vjet.”

3. Pas paragrafit të dytë shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

“Po kjo vepër e kryer në gjendje lufte ose në gjendje të jashtëzakonshme, dënohet me burgim jo më pak se njëzet vjet ose me burgim të përjetshëm ose me vdekje.”

Neni 9

Në nenin 33, në paragrafin e parë, pas fjalës “i shërbimit” hiqen fjalët “i ushtarëve, nënoficerëve” dhe shtohen fjalët “i ushtarakëve aktivë”.

Neni 10

Në nenin 34, në paragrafin e parë hiqen fjalët “oficerë dhe nënoficerë aktivë”.

Neni 11

Në nenin 36, në paragrafin e parë, pas fjalës “ushtarëve” shtohet fjala “aktivë”.

Neni 12

Në nenin 38, pas fjalëve “stërvitje ushtarake,” shtohen fjalët “prova gatishmërie ose mobilizimi”.

Neni 13

Në nenin 41, paragrafi i parë ndryshohet si më poshtë:

“Fjetja në shërbim, largimi nga vendi i shërbimit, përdorimi i pijeve alkoolike ose drogës gjatë shërbimit, shkelja e rregullave të sigurimit teknik të armëve në përdorim ose shkelja e urdhrave ose instruksioneve të veçanta që lidhen me objektin në ruajtje ose me natyrën e shërbimit, përbëjnë kundërvajtje penale dhe dënohen me ulje në gradë, nxjerrje në lirim ose burgim deri në dy vjet.”

Neni 14

Në nenin 45 bëhen këto ndryshime:

1. Në paragrafin e parë, pas fjalëve “personave për”, shtohen fjalët “shërbim ose”.

2. Pas paragrafit të parë të këtij neni, shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

“Kur nga kjo vepër kanë ardhur pasoja të rënda, dënohet me burgim nga dy deri në tetë vjet.”

Neni 15

Në nenin 46, fjalët “ushtaraku i cili” zëvendësohen me fjalët “cilido që”.

Neni 16

Në nenin 49 hiqen fjalët “nga ushtaraku” dhe pas fjalëve “Forcave të Armatosura”, shtohen fjalët “ose institucioneve të tjera ku bëjnë pjesë”.

Neni 17

Në nenin 50, paragrafi i parë ndryshohet si më poshtë:

“Kundërshtimi që i bëhet cilitdo personi të personelit të shërbimit, kur është duke kryer detyrat e shërbimit ushtarak ose shërbime të tjera, si dhe shtrëngimi i tij për t’i shkelur ato, dënohet me burgim deri në pesë vjet.”

Neni 18

Në nenin 51 bëhen ndryshimet si më poshtë:

1. Paragrafi i parë ndryshohet si vijon:

“Kundërshtimi i eprorit të tij officer, gjatë kohës që është në detyrë ose për shkak të saj, ose sjelljet ndaj tij me përbuzje ose pa respekt, me fjalë ose veprime, dënohen me nxjerrje në lirim ose me burgim deri në tre vjet.”

2. Pas paragrafit të parë shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

“Po kjo vepër e kryer në bashkëpunim, me dhunë fizike ose më shumë se një herë, dënohet me burgim nga dy deri në shtatë vjet.”

Neni 19

Neni 52 ndryshohet si më poshtë:

“Kundërshtimi i eprorit të tij nënoficer, gjatë kohës që është në detyrë ose për shkak të saj, ose sjelljet ndaj tij me përbuzje ose pa respekt, me fjalë ose veprime, përbëjnë kundërvajtje penale dhe dënohen me ulje në gradë, me gjobë, nxjerrje në lirim ose me burgim deri në një vit.

Po kjo vepër e kryer në bashkëpunim, me dhunë fizike ose më shumë se një herë, dënohet me burgim deri në pesë vjet.”

Neni 20

Neni 53, paragrafi i dytë ndryshohet si më poshtë:

“Po kjo vepër e kryer në bashkëpunim, me dhunë fizike ose më shumë se një herë, dënohet me burgim nga dy deri në shtatë vjet.”

Neni 21

Në nenin 54, fjalët “Ushtaraku, i cili” zëvendësohen me fjalët “cilido që”.

Neni 22

Neni 59 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 59
Vjedhja

Vjedhja e pasurisë në repart ose në vendin e shërbimit dënohet me burgim deri në dhjetë vjet.
Vjedhja e pasurisë, si armatim, municion, mjete materiale e pajisje ose e sendeve të tjera, të shoqëruara me dhunë ose me përdorim arme, dënohet me burgim nga shtatë deri në njëzet vjet.
Po këto vepra, kur kanë sjellë pasojë dëmtime të rënda të shëndetit ose vdekjen, dënohen me burgim jo më pak se pesëmbëdhjetë vjet ose me burgim të përjetshëm”.

Neni 23

Në nenin 63, paragrafi i parë, pas fjalës “Shkatërrimi” shtohen fjalët “ose dëmtimi”.

Neni 24

Neni 65 ndryshohet si më poshtë:
“Falsifikimi i dokumenteve të luftimit dënohet me burgim deri në dhjetë vjet.
Po kjo vepër e kryer në gjendje lufte ose në gjendje të jashtëzakonshme, dënohet me burgim nga dhjetë deri në njëzet vjet”.

Neni 25

Neni 70 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 70 **Shpërdorimi i detyrës**

Kryerja ose moskryerja me dashje e veprimeve ose e mosveprimeve në kundërshtim me ligjin, për përmbushjen e rregullt të detyrës, kur i ka sjellë pasoja të rënda shtetit ose interesave të ligjshëm të shtetasve, dënohet me gjobë, nxjerrje në lirim ose me burgim deri në pesë vjet.
Kur kjo vepër është kryer nga kuadri ose personeli komandues dënohet me burgim nga tre deri në tetë vjet.
Po kjo vepër e kryer në gjendje lufte ose në gjendje të jashtëzakonshme, dënohet me burgim nga pesë deri në pesëmbëdhjetë vjet.”

Neni 26

Në nenin 75, pas fjalës “Përdorimi” shtohet fjala “i paligjshëm”.

Neni 27

Neni 77 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 77 **Vrasja me dashje**

Vrasja me dashje e kryer nga eprori ndaj vartësit, nga vartësi ndaj eprorit ose ndërmjet tyre, për motive që lidhen me detyrën, dënohet me burgim jo më pak se pesëmbëdhjetë vjet ose me burgim të përjetshëm.
Po kjo vepër e kryer në gjendje lufte ose në gjendje të jashtëzakonshme, dënohet me burgim të përjetshëm ose me vdekje”.

Neni 28

Neni 79 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 79

Plagosja e rëndë me dashje

Plagosja e rëndë me dashje e kryer nga eprori ndaj vartësit ose e vartësit ndaj eprorit ose ndërmjet tyre, për motive që lidhen me detyrën, dënohet me burgim nga tre deri në dhjetë vjet.

Po kjo vepër, kur është kryer më shumë se një herë, kundër disa personave ose kur ka sjellë si pasojë vdekjen, dënohet me burgim nga pesë deri në pesëmbëdhjetë vjet.

Po kjo vepër e kryer në gjendje lufte ose në gjendje të jashtëzakonshme dënohet me burgim nga dhjetë deri në njëzet vjet”.

Neni 29

Neni 81 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 81

Plagosja e lehtë me dashje

Plagosja e lehtë me dashje e kryer nga eprori ndaj vartësit ose e vartësit ndaj eprorit ose ndërmjet tyre, për motive që lidhen me detyrën, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me ulje në gradë, me gjobë, me nxjerrje në lirim ose me burgim deri në dy vjet.

Po kjo vepër, kur është kryer më shumë se një herë ose kundër dy ose më shumë personave, dënohet me burgim nga një deri në tre vjet.

Po kjo vepër e kryer në gjendje lufte ose në gjendje të jashtëzakonshme dënohet me burgim nga dy deri në pesë vjet.”

Neni 30

Pas nenit 82 shtohen nenet 82/a dhe 82/b me këto përmbajtje:

“Neni 82/a

Kanosja

Kanosja serioze për vrasje ose për plagosje të rëndë e kryer nga eprori ndaj vartësit, nga vartësi ndaj eprorit ose ndërmjet tyre, për motive që lidhen me detyrën, dënohet me gjobë ose me burgim deri në dy vjet.

Po kjo vepër e kryer në kohë lufte ose në gjendje të jashtëzakonshme dënohet me burgim nga dy deri në pesë vjet.

Neni 82/b

Shkaktimi i vetëvrasjes

Shkaktimi i vetëvrasjes ose i tentativës së vetëvrasjes të vartësit, si rrjedhojë e trajtimit ose e sjelljes së keqe sistematike nga eprorët, kuadri ose personeli komandues, dënohet me burgim nga dy deri në pesë vjet.”

Neni 31

Pas nenit 87, shtohet neni 87/a me këtë përmbajtje:

“Neni 87/a

Përdorimi i mjeteve luftarake të ndaluara

Përdorimi nga ushtarakët i mjeteve ose i mënyrave të luftimit të ndaluara nga ligjet ose marrëveshjet ndërkombëtare, në të cilat vendi ynë është palë, kur kanë sjellë pasoja të rënda, dënohet me burgim nga pesë deri në dhjetë vjet.

Dhënia e urdhrit për përdorimin e mjeteve dhe mënyrave të ndaluara të luftimit, dënohet me burgim nga pesë deri në njëzet vjet.”

Neni 32

Në nenin 91, në titull, fjala “armiçësisë” zëvendësohet me fjalët “veprimeve luftarake” dhe në dispozitë, fjala “armiçësinë” zëvendësohet me fjalët “veprimet luftarake”.

Neni 33

Neni 92 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 92

Sjellja brutale me të plagosurit, me të sëmurët dhe robërit e luftës

Sjellja brutale me të plagosurit, me të sëmurët ose me robërit e luftës ose bërja e pamundur ose pengimi që të shfrytëzojë të drejtat e tyre të garantuara, sipas marrëveshjeve ndërkombëtare të pranuar nga shteti shqiptar, dënohet me burgim deri në tre vjet.”

Neni 34

Neni 94, paragrafi i parë ndryshohet si më poshtë:

“Vrasja ose plagosja e personave të kapur rob

Cilido që, duke shkelur dispozitat e marrëveshjeve ndërkombëtare të pranuar nga shteti shqiptar, kryen vrasje ose plagosje të rëndë të armikut që i ka dorëzuar armët, që është dorëzuar pa kushte, ose që nuk ka mjete për t’u mbrojtur, dënohet me burgim nga tre deri në dhjetë vjet.”

Neni 35

Në nenet 7, 12, 16, 35, 37, 38, 39, 44, 45, 46, 48, 49, 53, 54, 66, 68, 71, 72, 75, 76, 80, 82, 95 dhe 96 fjala “degradim” zëvendësohet me fjalët “ulje në gradë”.

Neni 36

Në nenet 16, 17, 20, 21, 22, 23, 24, 31, 32, 33, 34, 35, 36, 37, 38, 39, 40, 41, 42, 43, 44, 45, 46, 47, 50, 51, 55, 57, 62, 63, 67, 68, 74, 76, 83, 84 dhe 86 fjalët “kohë lufte” zëvendësohen me fjalët “gjendje lufte”.

Neni 37

Në nenet 30, 32, 44, 55, 56, 57, 58, 67, 68, 71, 72, 74 dhe 76 fjala “Ushtaraku” zëvendësohet me fjalët “Cilido”.

Neni 38

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekreten nr. 3409, datë 12.7.2002 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani

D E K R E T
Nr. 3397, datë 3.7.2002

PËR LEJIM LËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92 pika “c” të Kushtetutës, të neneve 15,19 dhe 20 të ligjit nr. 8389, datë 5.8.1998 “Për shtetësinë shqiptare”, bazuar edhe në propozimin e Ministrit të Rendit Publik,

D E K R E T O J:

Neni 1

U lejohej lënia e shtetësisë shqiptare me kërkesë të tyre personave të mëposhtëm:

1. Aurel Adnan Halili
2. Robert Stavri Tasho
3. Kesi Robert Tasho
4. Mimoza Shpëtim Tasho (Koni)
5. Leonora Preng Ktona (Lleshaj)
6. Pegi Maksim Ktona
7. Bettina Maksim Ktona
8. Cindy Maksim Ktona
9. Alqis Nikolla Stavru
10. Polikseni Alqis Stavru
11. Anastasia Alqis Stavru
12. Angjeliqi (Angelili) Kosta Stavru (Kostandini)
13. Shpresim Islam Malaj
14. Gazmend Memo Boci
15. Edmond Mersin Mema
16. Alban Edmond Mema
17. Ilirjana Shefqet Mema (Selime)
18. Dorina Edmond Mema
19. Orjeta Mevlan Dushollari
20. Anja Aleksandër Laçi
21. Mirela Xhevdet Schalow (Murati)
22. Artur Simon Rajta
23. Suzana Hasan Hondro (Jana)

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Rexhep Meidani

V E N D I M Nr. 152, datë 5.7.2002

“NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Fehmi Abdiu	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Zija Vuci	Anëtar i “““
Gjergj Sauli	Anëtar i “““
Alfred Karamuço	Anëtar i “““
Kujtim Puto	Anëtar i “““

Petrit Plloçi	Anëtar	i	“““
Sokol Sadushi	Anëtar	i	“““
Kristofor Peçi	Anëtar	i	“““

me sekretare Arbenka Lalica, në datën 31.5.2002, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.58 Akti që i përket:

KËRKUES: ARTUR ROSHI, përfaqësuar nga avokate Alma Çami, me prokurë.

SUBJEKT I INTERESUAR:

1. JANI KALLOJERI, përfaqësuar nga avokatët Përparim Sanxhaku e Evelina Qirjako, me prokurë.

2. MITRO, SPIRO, NIKO DUKSHI, në mungesë.

3. PANAJOT GUNARI, në mungesë.

4. ARBEN LEKA, në mungesë.

5. BASHKIA SARANDE, në mungesë.

6. KOMISIONI I KTHIMIT DHE KOMPENSIMIT Të PRONAVE SARANDë, në mungesë.

OBJEKTI: Shfuqizimi si antikushtetues i vendimit nr.1205, datë 13.11.2001 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.

Vendosja e masës së pezullimit të ekzekutimit të vendimit nr.238, datë 26.04.2000 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë.

BAZA LIGJORE:Nenet 42/1 e 131/f të Kushtetutës, neni 6 i Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut, neni 45 i ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.

Kërkuesi parashtron këto shkaqe për shfuqizimin e vendimit:

- Çështja në Kolegjin Civil është gjykuar në mungesë të tij, duke mos respektuar procedurat e njoftimit të rekursit.

- Në dosje ndodhet një dëftesë komunikimi në emër të avokatit Genc Nikolla, i cili ka deklaruar se nuk është nënshkrimi i tij dhe nga akti i ekspertimit grafik ka rezultuar se nënshkrimi është i falsifikuar.

- Heqja e të drejtës për të paraqitur kundërrekurs dhe për të marrë pjesë në gjykim e bën procesin gjyqësor të parregullt.

- Prishja e menjëhershme e ndërtimit cenon rëndë interesat e kërkuesit, sepse investimi i kryer kap vlerën 150 mijë USD, prandaj duhet të pezullohet ekzekutimi i vendimit të gjykatës.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Kristofor Peçi, përfaqësuesit e kërkuesit, të subjekteve të interesuara dhe shqyrtoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

Mbi padinë e personit të interesuar Jani Kallojeri, me objekt kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave Sarandë dhe pushim cenimi në pronësi, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Sarandë, me vendimin nr.238, datë 26.4.2000, ka vendosur anulimin e vendimit nr.294, datë 18.4.1996 të Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave Sarandë, përse i përket kthimit të 1000 m2 truall dhe detyrimin e kërkuesit Artur Roshi, me cilësinë e të paditurit, të pushojë cenimin në pronësi, duke mos kryer punime në këtë truall. Gjykata e Apelit Gjyrokastër, me vendimin nr.468, datë 14.9.2000, ka ndryshuar vendimin e gjykatës së rrethit dhe, duke e gjykuar çështjen në fakt, ka detyruar të paditurin Artur Roshi të pushojë cenimin në pronësi të paditësit Jani Kallojeri në pjesën veriore të kufizimit të tij deri tek muri kufizues në sipërfaqe 60 m2. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr.1205, datë 13.11.2001, ka vendosur prishjen e vendimit të gjykatës së apelit dhe lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së rrethit.

Mbledhja e Gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese, duke vlerësuar se ekzekutimi i këtij vendimi

mund të sjellë pasoja të rënda e të pariparueshme për kërkuesin, sepse ka të bëjë me prishjen e ndërtësës të ngritur në truallin objekt gjykimi, me vendimin e saj të datës 13.3.2002, vendosi pezullimin e ekzekutimit të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë.

Lidhur me kërkesën për shfuqizim të vendimit të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, Gjykata Kushtetuese çmon se ajo është e drejtë dhe duhet të pranohet për shkak të zhvillimit të një procesi gjyqësor të parregullt.

Nga shqyrtimi i çështjes rezultoi se kërkuesit nuk i është njoftuar rekursi që ka bërë pala kundërshtare, personi i interesuar Jani Kallojeri ndaj vendimit të gjykatës së apelit. Mungesa e këtij njoftimi i ka hequr atij të drejtën e mbrojtjes ndaj këtij mjeti për të paraqitur prapësimet e tij në një kundërrekurs, si dhe e ka privuar atë nga pjesëmarrja në gjykim në Gjykatën e Lartë, për të parashtruar pretendimet dhe për të mbrojtur të drejtën e tij. Zhvillimi i gjykimit në Kolegjin Civil të Gjykatës së Lartë, vetëm me personin e interesuar dhe, duke përjashtuar pa të drejtë kërkuesin, bie ndesh me parimin e kontradiktoritetit dhe e bën procesin të parregullt, në kuptimin kushtetues.

Mosnjoftimi i rekursit vërtetohet plotësisht nga veprimet e kryera në këto aspekte:

Së pari, njoftimi nuk i është adresuar vetë kërkuesit si palë e paditur, siç përcaktohet në ligj.

Së dyti, dëftesa e komunikimit nr.65, datë 14.10.2000, që ndodhet në dosje në emër të këtij avokati, nuk pasqyron të vërtetën.

Si nga pyetja e avokatit Genc Nikolla, me cilësinë e dëshmitarit, të bërë në seancë gjyqësore nga Gjykata Kushtetuese ashtu edhe nga akti i ekspertimit grafik datë 23.2.2002 të ekspertit kriminalist Sulo Hodo, rezulton se avokati nuk ka marrë kopje të rekursit dhe se firma në dokument nuk është e tij, por e falsifikuar.

Në këto rrethana, Gjykata Kushtetuese nuk krijon bindjen se kërkuesi është vënë në dijeni për rekursin. Fakti që Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë mund të jetë bazuar në dëftesën e komunikimit, e cila është e nënshkruar, dhe, si e tillë, është konsideruar e mjaftueshme pa kryer verifikimet e nevojshme, nuk mund ta bëjë procesin të rregullt, përderisa vërtetohet, si më sipër, se kërkuesi nuk është njoftuar. E rëndësishme është që kërkuesit objektivisht iu hoq mundësia për të realizuar të drejtat e tij kushtetuese në një proces gjyqësor dhe kjo e bën procesin të parregullt.

Me këtë rast, Gjykata Kushtetuese thekson se nuk ka rëndësi nëse gjykatat e sistemit të zakonshëm kanë qenë ose jo në dijeni të shkeljeve të ligjit, por sa dhe si në të vërtetë është zbatuar ligji për të garantuar jo vetëm të drejta teorike dhe iluzore, por të drejta që janë praktike dhe efektive për pjesëmarrësit në proces.

Përsa i përket pezullimit të ekzekutimit të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, Gjykata Kushtetuese thekson se një vendim i tillë është i detyrueshëm për zbatim nga të gjitha organet shtetërore dhe shtetasit. Në bazë të nenit 45 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, pezullimi vazhdon derisa vendimi përfundimtar i Gjykatës Kushtetuese të hyjë në fuqi. Për këto arsye, qëndrimi i mbajtur nga Drejtoria e Përgjithshme e Përmbarrimit pranë Ministrisë së Drejtësisë, e cila me shkresën nr.A-51/1, datë 10.4.2002, drejtuar Zyrës së Përmbarrimit Sarandë, shprehet se vendimi i Mbledhjes së Gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese nuk i shtrin efektet mbi vendimin për pezullimin e punimeve, është i pabazuar.

PËR KETO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në bazë të neneve 131/f e 134/g të Kushtetutës, si dhe neneve 72 e 77 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, me shumicë votash,

V E N D O S I:

- Shfuqizimin si antikushtetues të vendimit nr.1205, datë 13.11.2001 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.

- Dërgimin e çështjes për shqyrtim Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.

- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

MENDIMI I PAKICËS

Nuk jam i një mendimi me shumicën, e cila, duke marrë si të vërtetuar pretendimin e kërkuarit se nuk i është njoftuar rekursi, ka konkluduar se vendimi i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë është rezultat i një procesi jo të rregullt ligjor.

Kështu, gjatë gjykimit në Gjykatën Kushtetuese, kërkuari ka pretenduar se njoftimi i rekursit i është adresuar avokatit të tij zotit Genc Nikolla, e jo personalisht atij. Sipas kërkuarit, njoftimi i rekursit avokatit nuk barazohet me njoftimin drejtpërdrejt atij.

Lidhur me këtë pretendim, mendoj se njoftimi i rekursit, duke ia adresuar avokatit të kërkuarit, është i rregullt e i ligjshëm. Kështu, avokati me prokurë vepron në emër e për llogari të të përfaqësuarit dhe ka tagra të kryejë gjithshka që është në funksion të gjykimit të çështjes. Në këtë vështrim, edhe njoftimi i adresuar përfaqësuesit barazohet me njoftimin që i adresohet vetë të të përfaqësuarit.

Përveç kësaj, nga ana e kërkuarit është pretenduar se njoftimi i rekursit është i falsifikuar. Këtë pretendim shumica e ka pranuar si të provuar, duke pranuar si provë një akt ekspertimi, i cili është paraqitur në mënyrë të njëanshme nga kërkuari. Për pasojë, l`mendoj se ky ekspertim nuk mund të merret për bazë për të provuar pretendimin e kërkuarit, pasi është kryer në kundërshtim me rregullat e përcaktuara nga nenet 11 e vijues, 80 e vijues si dhe 225 e vijues të Kodit të Procedurës Civile. Gjithashtu, gjykata ka pranuar si provë edhe shpjegimet e avokatit të kërkuarit, i cili është shprehur se nuk e ka nënshkruar njoftimin e rekursit. Edhe këto shpjegime duhet të merren me rezervë, sepse dëshmitari duke qenë avokat i kërkuarit, është i interesuar në zgjidhjen e çështjes.

Në këto rrethana, përderisa njoftimi është i vlefshëm sepse janë respektuar rregullat procedurale të njoftimit dhe nga ana tjetër nuk provohet pretendimi për falsitetin e këtij njoftimi, mendoj se kërkesa e paraqitur duhet të rrëzohet.

ANËTAR
P. Pllaçi

Fletorja Zyrtare gjendet:

- Në çdo njësi postare të çdo qyteti;
 - Pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare:
- Rr.Qemal Stafa, pranë ndërtesës së Prokurorisë së Përgjithshme.

U dorëzua për shtyp më 15. 7. 2002
Doli nga shtypi më 16. 7. 2002

Tirazhi: 4250 copë	Formati: 60x88/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2002

Çmimi: 100 lekë